# KUMTESAT

nga konferenca vjetore e shkencës 'Java e Shkencës' 2016

Redaktor:
Dr. Murteza Osdautaj

NJ
TÏ

Doc
Dep
Uni
Shk

S
tash
N
folr
hab
gjer
hab
N
shu
K
mo
cilë
pre
Dia

larmishme me synim të një shkrirjeje mes veti.[1]

Nga gjithë ç'u tha më sipër, nënkuptohet se kemi të bëjmë me tri të folme të ndryshme brenda një rrethine të njëjtë dhe, meqenëse, objekt studimi në këtë kumtesë kemi mënyrën habitore të rrethit të Strugës, do të paraqesim pasqyrën e zgjedhimit të foljeve të mënyrës habitore krahas njëra-tjetrës për të tria të folmet e këtij qarku.

Mënyra habitore (admirativi) siç dihet më, është mënyrë e veçantë foljore dhe specifike vetëm për gjuhën shqipe sipas tipit të ndërtimit, e cila përdoret për të shprehur habi nga një ngjarje e papritur, por edhe nuanca ironizimi, mospajtimi a kundërshtimi, përbuzje, injorim. Kur folësi shpreh habi për një veprim që nuk është kryer në të kaluarën ose në momentin kur flet, atëherë para formave të habitores përdor pjesëzat mohuese s' dhe nuk.[2]

Në shqipen standarde ekzistojnë gjithsej katër forma të habitores: një formë foljore për kohën e tashme dhe tri forma foljore për të shprehur habi në kohën e shkuar: e pakryera (imperfekti), e kryera (perfekti) dhe më se e kryera (pluskuamperfekti). Por, në të folmet e rrethit të Strugës, nga të gjitha këto forma që përmendëm, përdoren vetëm forma e habitores për kohën e tashme dhe për të kryerën. Megjithëkëtë, në këto të folme hasëm një formë të re të habitores që shpreh kohën e ardhme, e cila është një veçanti gjuhësore që nuk gjendet as në shqipen standarde dhe as në ndonjë të folme tjetër dialektore.[3]

Koha e tashme e habitores ka formë sintetike, aglutinative dhe ndërtohet nga forma e shkurtuar e pjesores së foljes themelore + folja ndihmëse kam në kohën e tashme për formën veprore. p.sh.:

| folja mësoj | | |
|---|---|---|
| Njëjës | | |
| toskërisht | e folmja kalimtare | gegërisht |
| 1. mësokur-kam / mësua-kam | mëson-kam | msô-kom |

Koha e shkuar e habitores në këtë të folme, sikurse edhe në shqipen standarde, ndërtohet me format e foljes ndihmëse kam në kohën e tashme habitore + pjesorja e foljes themelore, p.sh.:

folja vij (paskam ardhur)

| toskërisht | |
|---|---|
| 1. paskam ardhur | 1. paskemi ardhur |
| 2. paske ardhur | 2. paskeni ardhur |
| 3. paska ardhur | 3. paskan ardhur |

| gegërisht | |
|---|---|
| 1. paskom ardh | 1. paskimi ardh |
| 2. paske ardh | 2. paskini ardh |
| 3. paska ardh | 3. paskan ardh |

| e folmja kalimtare | |
|---|---|
| 1. paskam ardh | 1. paskemi ardh |
| 2. paske ardh | 2. paskeni ardh |
| 3. paska ardh | 3. paskan ardh |

folja laj (paskam larë)

| toskërisht | |
|---|---|
| 1. paskam la:r(ët) | paskemi la:r(ët) |
| 2. paske la:r(ët) | paskeni la:r(ët) |
| 3. paska la:r(ët) | paskan la:r(ët) |

*Nesër do rënka shi, ashu than lajmet.* (tosk.)
*Nesër dë binka shi, ashtu than lajmet.* (kal.)
*Nesër dë bika shëi, ashtoû than lajmet.* (geg.)
*Nesër dë ronka shëi, ashtoû than lajmet.*(Misllodezhdë)

*Siç duket, sonte do qënka ftoft.* (tosk.)
*Siç duket sonte dë qënka ftoft.* (kal.)
*Si duket, sonte dë qoka ftoft.* (geg.)

*Edhe ti do vish ande? Epo z'do mërziteshkam.* (tosk)
*Edhe ti dë vish andej? Epo z'dë mërziteshkam.* (kal.)
*Ene tëi dë vëish andi? Epo z'dë mbërziteshkom.* (geg.)

*Ajo që t'm'i ype nervat thoshte, sikur ti dë më thonke që ajo ta dha shallin e jo unë.* (kal.)
*Ajuo çi t'm'i ipe nervat thote, gjase tëi dë m'thôke çi ajuo ta dha shallin, juo oune.* (geg)

*Nëse vinke nga ora pe:s, dëmethën dë më gjenke vet* (kal.)
*Po t'vëish nga ora pes demek dë m'gjike vet.* (geg.)

*Of, of, of ajo dë bonka bakllav! Ajo s'ka lidhje me bakllavën.*(kal.)
*Of, of, of ajo do boka bakllava! Ajo s'ka lidhje me bakllavan.*(tosk.)
*Of, of, of ajuo dë boka bakllav! Ajuo s'ka lidhje me bakllavën.*(geg.)

*Ajo më tha që dë visheshkemi si nuse e dë shkonkemi mbas darke*
*Ajo më tha që do u veshkemi si nuse e do shkokemi pas darke*
*Ajuo m'tha qi dë vëisheshkimi si nouse ene dë shkohimi mbas darke etj.*

BIBL

AKAD
Diale
AKAD
Diale
BECI,
BECI,
Shko
FADIL
Prish
GJINA
Insti
GJINA
GJINA
GJINA
HAMI
HAMI
IBRAI
Shku
MURA
II (D
NESIN
OSMA
OSMA
QAMI